

VENDIM
Nr. 88, datë 15.2.2006

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES STRUKTUREORE DHE SHPËRBLIMIN E
KËSHILLIT KOMBËTAR TË SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 9 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e përbërjes strukturore të Këshillit Kombëtar të Sportit, i cili të kryesohet nga zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në përbërje të ketë 14 anëtarë si më poshtë vijon:

- Zëvendësministrin e Financave	anëtar;
- Zëvendësministrin e Arsimit dhe Shkencës	anëtar;
- Zëvendësministrin e Shendetësisë	anëtar;
- Zëvendësministrin e Brendshëm	anëtar;
- Zëvendësministrin e Mbrojtjes	anëtar;
- Drejtorin e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Futbollit	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Basketbollit	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Volejbollit	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Atletikës	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes	anëtar;
- Presidentin e Federatës Shqiptare të Boksit	anëtar;
- Presidentin e Komitetit Olimpik Shqiptar	anëtar;
- Rektorin e Akademisë së Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”	anëtar;
- Një specialist nga Drejtoria e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	koordinator/ sekretar.

2. Këshilli Kombëtar i Sportit thirret si rregull nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, jo më shumë se 4 herë në vit.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha